



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1216/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Kadrie Ukshini kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Viti, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

#### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Kadrie Ukshini, kandidate për anëtare të kuvendit komunale në Viti.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:31 nga kandidatja për anëtare të kuvendit komunale Kadrie Ukshini, ku ka pretenduar se janë bërë manipulime nga KQZ-ja ku në VV nr:2609/D ,1,2,3 në fshatin Gjylekar gjatë numërimit të votave më janë shmangur votat, thuhet në pretendimet e ankuesit. Parashtruesi i ankesë nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

#### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të kandidates për anëtare të kuvendit komunale Kadrie Ukshini janë të pa argumentuara sepse nuk e ka specifikuar subjektin politik dhe pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi bindëse, për tu vërtetuar për shkeljen e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 1216/2013 më datën 06.12.2013.



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.